

VENDIM
Nr. 666, datë 7.8.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE
PUBLIKE, GURËZ, NË KOMUNËN E FUSHË-KUQES TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike Gurëz, në komunën e Fushë-Kuqes, të qarkut të Lezhës.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të komunës së Fushë-Kuqes.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 3 499 (tri mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², tokë arë, në vlerën e përgjithshme të shpronësimit 1 179 163 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 179 163 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet nga buxheti i planifikuar për komunën e Fushë-Kuqes.
 5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna e Fushë-Kuqes.
 7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna e Fushë-Kuqes, për realizimin e këtij projekti.
 8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 3 499 (tri mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², tokë arë, shpronësuar në favor të komunës së Fushë-Kuqes, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna e Fushë-Kuqes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR “ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE GURËZ” NË KOMUNËN E
FUSHË-KUQES, QARKU LEZHË**

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	Sip. arë m ²	Çmimi, lekë/m ²	Vlera në lekë	Numri i pasurisë	Zona kadastrale	Dok. i pronësisë
1	Lek Mirash Huli	3 499	337	1 179 163	54/10	1890	Certifikatë pronësie
	Totali	3 499		1 179 163			